

VENDIM
Nr.39, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT
PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, LICENCËS SË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LICENCËS SË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 13 dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” nenit 18, pika 1, germa “g”, dhe nenit 26, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me draftet e paraqitura, të licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta